



Data: 01/12/2023

PROGRAMI I PRAKTIKËS NË PUNË KOMUNA DRAGASH

Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të datës 15.12.2021 të lidhur mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Komunës e Dragashit, në kuadër të projektit "Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2), **shpallet thirrja për aplikim për Praktikë në Punë (Internship) për mbështetje për personat e diplomuar të papunësuar**, në bashkëpunim me ndërmarrjet nga sektori privat, institucionet publike, departamentet e komunës dhe Organizatat e Shoqërisë Civile.

RRETH PROGRAMIT

Programi **Praktikë në Punë (Internship)** ka për qëllim të ju ofrojë mundësinë punëkërkesëve të papunësuar të moshës deri në 24 vjeç që kanë diplomuar në dy vitet e fundit në nivelin Bachelor dhe në atë Master të arsimit të lartë, të ndjekin një praktikë 4 (katër) mujore në ndërmarrjet e sektorit privat, organizatat e shoqërisë civile dhe në institucione publike, me qëllim të përkrahjes së aftësimin praktik në punë apo edhe punësimit të qëndrueshëm në Kosovë.

Programi fokusohet në identifikimin e ndërmarrjeve/institucioneve që kanë potencial të ofrojnë mundësi afatgjate të punësimit. Përveç përkrahjes së punëkërkesve të papunë në gjetjen e mundësive për praktikë, programi Praktikë në Punë lehtëson të gjithë procesin e identifikimit dhe përputhjes së punëkërkesve me kërkesat e kompanive/institucioneve.

PROGRAMI PRAKTIKË NË PUNË REALIZOHET SIPAS HAPAVE NË VIJIM:

Kushtet e Përgjithshme: Punëkërkesit dhe Punëdhënësit potencial të këtij programi duhet të vizitojnë Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) në Komunën e Dragashit duke dorëzuar formularin për aplikim, si shprehje e interesimit për programin Praktikë në Punë.

Hapi i Parë: Komuna e Dragashit shpallë thirrjen për aplikim për Punëkërkesit dhe Punëdhënësit, dhe njëkohësisht informohen rreth programit të Praktikës në Punë dhe mbi kërkesat e përgjithëshme të skemës.

Hapi i Dytë:

a) Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) në kuadër të Komunës së Dragashit në bashkëpunim me zyrtarin koordinator/ apo zv. koordinatorin nga komuna e Dragashit për projektin ReLOaD2, identifikon kompanitë, institucionet, departamentet dhe OSHC-të të cilat ofrojnë kushte të përshtatshme për kryerjen e praktikës në profesionin përkatës sipas profilizimit të punëkërkesit gjatë procesit të aplikimit.

Hapi i Tretë: Ndërmarrjeve, Institucioneve, departamenteve nga komuna dhe OSHC-ve që shprehin interesim për të pranuar praktikantë, do t'i dërgohen të dhënat e kandidatëve sipas profilit të kërkuar nga ta. Pas konfirmimit nga ndërmarrja, institucioni, departamenti nga komuna



dhe OSHC-të për pranim të ndonjërit prej kandidatëve për praktikë, Komuna e Dragashit në bashkëpunim me projektin ReLoaD2/UNDP, shqyrtojnë aplikacionet e pranuar. Pas procesit të selektimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve, nënshkruhet Marrëveshja për Praktikë në Punë ndërmjet praktikantit/es dhe ndërmarrjes, Institucionit, departamentit nga komuna dhe OSHC-së.

KUSH MUND TË APLIKOJË?

NDËRMARRJET, INSTITUCIONET, DEPARTAMENTET E KOMUNËS DHE ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Të drejtë aplikimi kanë:

- Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme nga sektori privat,
- Ndërmarrjet e regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK),
- Ndërmarrjet të cilat janë aktive në Administratën Tatimore të Kosovës,
- Institucionet e sektorit publik në Komunën e Dragashit.
- Departamentet nga komuna e Dragashit, dhe
- Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të).

Ndërmarrjet, Institucionet, departamentet e komunës dhe OSHC-të që mund të dëshmojnë se janë të interesuara në ofrimin e punësimit afatgjatë të kandidatëve, do të kenë prioritet.

Aplikimi

Të gjitha Ndërmarrjet, Institucionet, departamentet e komunës dhe OSHC-të e interesuara për aplikim, duhet t'i dorëzojnë fizikisht në DKRS në Komunën e Dragashit dokumentet si në vijim:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, dëshmi si taksapagues aktiv në ATK dhe kopjen e letërnjoftimit të pronarit (**ndërmarrjet**),
- Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së dhe dëshmi si taksapagues aktiv në ATK (**OSHC-të**)
- Shkresën e personit të autorizuar (**Institucion dhe departament të komunës**)
- Formularin për aplikim (të plotësuar nga personi i autorizuar)

Kush nuk mund të aplikojë?

- OSHC-të me veprimtari të ndaluar nga departamenti i OJQ-ve
- Veprimtaritë financiare dhe të sigurimeve dhe veprimtaritë që përfshijnë bixhozin, sallonet e masazheve;
- Prodhimi i pijeve me përmbajtje të lartë të alkoolit, prodhimi dhe shpërndarja e armëve;
- Bizneset që përdorin teknologji që çojnë në ndotje të mjedisit (si ndotje të ajrit, ujit, tokës etj.);
- Bizneset jo-formale;



APLIKUESIT (TË DIPLOMUARIT)

Të drejtë aplikimi për Praktikë në Punë (Internship) kanë personat që i përmbushin të tri kushtet si në vijim:

- Të diplomuarit në universitet në dy vitet e fundit (në nivelin Bachelor apo Master të arsimit të lartë),
- Punëkërkuarit që nuk kanë përvojë të mëparshme pune, dhe
- Punëkërkuarit deri në moshën 24 vjeçare.

Prioritet do të kenë:

- vajzat dhe gratë,
- personat me aftësi të kufizuara,
- prindërit vetëushqyes dhe
- pakicat etnike në nivelin lokal

Personat që kanë përfituar më parë nga skema Praktikë në Punë, nuk kanë të drejtë aplikimi.

Aplikimi

Dokumentet e nevojshme për aplikim për programin Praktikë në Punë janë:

- Diploma e shkollimit të lartë universitar Bachelor apo Master (kopje e qartë e noterizuar)
- Formulari i aplikimit, i plotësuar detajisht
- Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit
- Dëshmia e regjistrimit si punëkërkuar në Zyren e Punësimit.

Rastet e konfliktit të interesit me palët e përfshira dhe vendimmarrësit e programit Praktikë në Punë, nuk kualifikohen që të përfitojnë nga programi.

MBËSHTETJA FINANCIARE

Kostoja e praktikës për praktikantë do të mbulohet nga Programi. Pagesat i bëhen drejtëpërdrejt praktikantit me transferim bankar. Pagesat bëhen në baza mujore në vlerë prej 170.00 EUR (NETO) në muaj.

Kandidatët të cilët e përfundojnë praktikën (4) katër mujore do të pajisen me certifikatë për përfundimin e praktikës.

AFATI PËR APLIKIM

Afati i fundit i aplikimit: 29.12.2023, në DKRS në KK Dragash.

Format e aplikimit mund t'i gjeni në DKRS në Dragash.



Rreth projektit ReLOaD2 në UNDP Kosovë

Projekti ReLOaD2 i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i implementuar nga UNDP në Kosovë, në bashkëpunim dhe koordinim me zyret homologe në 5 vendet/territoret tjera të Ballkanit Perëndimor, synon forcimin e demokracive gjithëpërfshirëse dhe procesit të integritit në Bashkimin Evropian (BE) në Ballkanin Perëndimor përmes fuqizimit të shoqërisë civile dhe të rinjëve për të marrë pjesë aktive në vendimmarrje dhe duke stimuluar një mjedis ligjor dhe financiar të përshtatshëm për OSHC-të.

Duke filluar nga viti 2022, fokusi i Projektit është në aktivitetet me të rinjtë për të lehtësuar dhe adresuar më mirë punësimin dhe punët e denja drejt perspektivave më të mira për të rinjtë në komunat partnere. Fokusi këtë vit do të jetë në aftësimin profesional dhe në trajnimet në punës, që synojnë të krijojnë vende të reja pune për individët më të cenueshëm në komunitet (me fokus tek gratë që kontribuojnë në familje, të rinjtë që kërkojnë punën e tyre të parë, individët në papunësi afatgjate, njerëz të kualifikuar të nënpunësuar, njerëz që jetojnë në varfëri, si dhe persona me aftësi të kufizuara).